



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1186 Prot.

Tiranë, më datë 03.12.2020

VENDIM
Nr. 454, datë 03.12.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 03.12.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të sondazheve arkeologjike, ku shtrihet projekti zhvillimor: “Zona e re për zhvillim të Zonës 1 në Njësinë Administrative Lezhë”, Bashkia Lezhë, realizuar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, “MEET ENGINEERING” sh.p.k., Taulant RAMA dhe Skënder MUÇAJ;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektet që do të zhvillohen në “Zona e re për zhvillim të Zonës 1 në Njësinë Administrative Lezhë”, Bashkia Lezhë dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETAR

Arta DOLLANI

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta
Dollani
DN: cn=AL, o=Instituti i
Monumenteve të
Kultures, title=Dragëtor i
Pergjithshem, cn=Arta
Dollani
Date: 2020.12.03
16:05:55 +01'00'

Elva
Margariti

Digitally signed by
Elva Margariti
Date: 2020.12.03
16:59:18 +01'00'